



BPrAL - PPOHE
Kolegji AAB

Rregullorja e studimeve të doktoratës në AAB

Përmbajtja

Hyrje	4
Llojet e programeve të doktoratës në AAB dhe përshkrimet e tyre.....	5
Standardet për themelimin e programeve të reja.....	5
Kriteret për përgatitjen e programeve	6
3.1 Karakteristikat kryesore të programeve të studimeve të shkallës së tretë:.....	6
3.2 Përmbajtja e propozimeve të programit për nevoja të aprovimit në Senat dhe për akreditim janë: ...	6
Vlerësimi i kredive dhe elementet e organizimit të mësimi.....	6
4.1 Vlerësimi i kredive në bazë të kriterëve të ECTS	6
4.2. Format e studimit	7
4.2.1 Format e organizuara të studimit (60 kredite):.....	7
4.2.2 Studimet për disertacionin e doktoraturës (rreth 120 kredit):	7
Pranimi i studentëve.....	8
Mekanizmat kryesorë, kushtet për bartësit e lëndëve dhe mentorët	8
Dijet dhe aftësitë e përgjithshme (gjenerike)	10
Procesi i miratimit, freskimit dhe ri-akreditimit të programeve të doktoraturës.....	10
Shpallja e konkursit për pranimin e studentëve	11
Përcaktimi i kërkesave themelore dhe barasvlerësimi për regjistrim në studimet e doktoraturës	11
Aplikimi dhe përzgjedhja e kandidatëve.....	11
Kontrata e studimeve	11
Studimet dhe punimi i disertacionit të doktoratës.....	12
Temat për disertacion.....	12
Emërimi dhe puna e komisioneve për vlerësimin e temës	13
Teza e doktoratës dhe mbrojtja	13
Hartimi i doktoratës në një gjuhë të huaj	14
Promovimi	14
Përgatitja e materialeve për promovim	14
Promovimi formal i doktoraturave të reja / doktorëve të shkencave	15

Në bazë të nenit 4, paragrafi 2, pika 2.3 të Ligjit nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe nenit 80 paragrafi 1 pika (b) dhe nenit 83 të Statutit të Kolegjit AAB, Senati në mbledhjen e mbajtur më datën _____ miratoi këtë:

R R E G U L L O R E

PËR ORGANIZIMIN E STUDIMEVE TË DOKTORATËS

Rregullorja për organizimin e studimeve të doktoratës (në tekstin e mëtejshëm “Rregullorja”) mbështetet në Statutin e Kolegjit AAB dhe Ligjin për Arsimin e Lartë.

Qëllimi i nxjerrjes së kësaj Rregulloreje është:

- a) Të rregullojë përmbajtjen, strukturën dhe mënyrën e organizimit të studimeve të doktoratës sipas sistemit të Bolonjës dhe standardeve evropiane mbi Arsimin e Lartë;
- b) Të përcaktojë organet përgjegjëse për organizimin e studimeve të doktoratës;
- c) Të përcaktojë format dhe kohëzgjatjen e studimeve të doktoratës;
- d) Të parashohë kushtet për pranimin dhe regjistrimin e studentëve;
- e) Të rregullojë procedurën lidhur me temën e disertacionit;
- f) Çështje të tjera rreth temës;
- g) Të përcaktojë rregulla të tjera që kanë të bëjnë me përfundimin e studimeve të doktoratës dhe çështje të tjera më rëndësi.

Hyrje

Informacioni i mbledhur në këtë dokument paraqet bazën për hartimin dhe zbatimin e studimeve të doktoratës nga fillimi, d.m.th. nga dizajni i programit për zbatimin e saj deri te promovimi final i doktorëve, duke përfshirë dhe parimet themelore dhe qëndrimet e formuara në shkallë të universitetit.

Ky dokument përmban vetëm ato kritere për përgatitjen e programeve dhe procedurave të zbatimit, të cilat janë të zakonshme për të gjitha programet doktorale në AAB. Kërkesat e veçanta ose specifike, të cilat mund të jenë veçanërisht të rëndësishme në zbatimin e disa programeve individuale janë përshkruar në rregulloret e veçanta ose në materiale të tjera informative të fakulteteve përkatëse.

Udhëzimet e këtij dokumenti bazohen në dispozitat e kërkesat ligjore për programet e doktoraturës, në kushtet e përcaktuara në Statutin e AAB-së, në politikat e MASHT, në rekomandimet e AKA-së për studimet e doktoratës për programet e reja të doktoratës dhe zbatimin e tyre, si dhe rekomandimet e Asociacionit të Universiteteve Evropiane (EUA). Ky dokument është bazuar po ashtu në rregulloret përkatëse të disa universiteteve evropiane, e në veçanti në atë të Universitetit të Lubjanës për studimet doktorale.

Cilësia e organizimit të studimeve të doktoratës është një nga kriteret më të rëndësishme për përsosmëri në universitete dhe ka një ndikim të madh në reputacionin e saj në arenën ndërkombëtare. AAB në misionin dhe strategjisë e vet, për 2013-2018 ka vendosur si vlerë themelore përsosmërinë akademike dhe kërkimet shkencore, për të cilat cilësia e studimeve të doktoratës mund të kontribuojnë në një pjesë të madhe. Procesi i sigurimit të cilësisë së studimeve të doktoratës lidhet kryesisht me menaxhimin cilësor të procesit të projektit hulumtues deri në punimin e doktoratës, përfshirë dhe rezultatet përkatëse shkencore.

Kriteret për sigurimin e cilësisë janë përgjegjësi e Komisionit për Studime të Doktoratës, i cili në të gjitha fazat e monitoron dhe vlerëson tërë procesin e studimeve doktorale.

Neni 1

Llojet e programeve të doktoratës në AAB dhe përshkrimet e tyre

Programet doktorale dallojnë kryesisht për nga shkalla e ndërveprimit dhe mënyra e organizimit.

Në AAB organizohen këto lloje të programeve doktorale:

- Programet e doktoratës me një qasje interdisiplinare të fortë dhe të bashkërenduara në nivel të Universitetit, të quajtur "Programi interdisiplinar i doktoraturës...(vijon titulli në shqip)", ose në përkthim anglisht, "Interdisciplinary doctoral programme ...(pason titulli në anglisht)"
- Programet e doktoratës që përkojnë me fushat e studimeve / fakulteteve / programeve të caktuara, të cilat edhe bëjnë koordinimin e programeve, të quajtura "Programi i Doktoraturës ...(vijon titulli në shqip)", ose në përkthim anglisht, "Doctoral programme in ...(vijon titulli anglisht)"
- Programe të përbashkëta të doktoraturës që AAB përgatit së bashku me partnerë universitarë në Kosovë dhe jashtë saj - me partnerët e huaj, të quajtur "Programi i përbashkët i doktoraturës...(vijon titulli)", ose në përkthim anglisht, "The Joint Doctoral Programme...(vijon titulli në anglisht).

Neni 2

Standardet për themelimin e programeve të reja

Standardet minimale për përcaktimin e fushës shkencore për studime të nivelit të tretë të programeve të studimit janë:

- Kriteret shkencore: duhet të jetë një hulumtim adekuat shkencor,
- Kriteret pedagogjike: duhet të ketë një numër të mjaftueshëm të profesorëve, të cilët mund të prodhojnë të paktën dy kurse bërthamë dhe disa zgjedhore,
- Nevoja e identifikuar për zhvillimin e fushës shkencore,
- Programi kornizë kërkimor – shkencor në nivel institucional që mundëson kryerjen e hulumtimeve kërkimore, përfshirë për studime të doktoratës,
- Infrastruktura e përshtatshme kërkimore shkencore.

Neni 3

Kriteret për përgatitjen e programeve

3.1 Karakteristikat kryesore të programeve të studimeve të shkallës së tretë:

- Kohëzgjatja e studimeve: 3 vjet
- Vëllimi: shuma e përgjithshme prej 180 kredive, të paktën 60 kredi me forma të organizuara të studimit; të gjitha studimet dhe format e punës ofrojnë kompetenca të përgjithshme – shkathtësi të transferueshme dhe dijet përkatëse teorike – akademike.
- Programet vlerësohen sipas ECTS.

3.2 Përmbajtja e propozimeve të programit për nevoja të aprovimit në Senat dhe për akreditim janë:

- Informacion i përgjithshëm rreth programit,
- Objektivat kryesore të programit dhe kompetencat e përgjithshme ose specifike lëndore (të shprehura në rezultate mësimore),
- Të dhënat mbi krahasueshmërinë ndërkombëtare të programit,
- Informacioni mbi bashkëpunimin ndërkombëtar të institucionit të arsimit të lartë,
- Kurrikula me një përlllogaritje të kredive ECTS të obligimeve të studimeve,
- Kërkesat për pranim dhe kriteret e përzgjedhjes (me rastin e numrit të kufizuar të kandidatëve të pranuar),
- Kriteret për pranimin e njohurive dhe aftësive të fituara para regjistrimit në program,
- Kërkesat dhe kushtet për përparimin e studentit në program,
- Kushtet për transfer prej programeve të tjera,
- Kushtet që duhen plotësuar për përfundimin e programit,
- Përcaktimi i titujve akademikë, të hartuar në përputhje me ligjin.

Neni 4

Vlerësimi i kredive dhe elementet e organizimit të mësimi

4.1 Vlerësimi i kredive në bazë të kriterëve të ECTS

Për vlerësimin e aspekteve të krediteve të programeve të studimit do të përdoret Sistemi Evropian i Transferimit të Krediteve (ECTS), i cili u siguron studentëve mundësinë e akumulimit dhe transferimit të krediteve.

Sipas kriterëve të ECTS janë bërë përlllogaritjet e mëposhtme:

- Programet e doktoraturës përbëjnë 180 ECTS dhe zgjasin tri vite,

- 1 pikë-kredi përbëhet nga 25 deri në 30 orë të ngarkesës së studentit, ngarkesa e punës vjetore studentore është 1500-1800 orë,
- Programet e studimit duhet të organizohen në mënyrë që çdo vit të ofrohen / fitohen 60 kredite, nga 30 kredite për semestër,
- Kurset individuale duhet të vlerësohen nga të paktën tri kredite, numri i rekomanduar i krediteve për secilin modul të jetë të paktën 5 ose një shumëfish i këtij numri.

4. 2. Format e studimit

Studimet janë të organizuara në dy pjesë: format e organizuara të studimit (60 kredite) dhe punimi i disertacionit (120 kredi). Mësimi i organizuar përbën rreth një të tretën e ngarkesës së studentit, ndërsa puna kërkimore përbën rreth dy të tretat e të gjitha detyrimeve të studentit.

4.2.1 Format e organizuara të studimit (60 kredite):

Tërësia teorike dhe metodologjike shkencore në këtë kontekst përfshin lëndët e programit të doktoraturës me forma të ndryshme të mësimdhënies:

- Lëndët teorike – në forma të organizuara të studimit dhe provimit,
- Lëndët metodologjike, në të cilën kandidati përzgjedh përmbajtjen e metodave kërkimore individuale dhe / ose teknikat hulumtuese,
- Mundësia e provimeve të doktoratës (baza teorike për disertacionin e doktoraturës), e cila mund të përfshihet edhe në kushte të përparimit të studentit nëpër studime.

4.2.2 Studimet për disertacionin e doktoraturës (rreth 120 kredit):

Në parim studimi kërkimor dhe hulumtues i shprehur në ECTS nuk vlerësohet sipas të njëjtave norma si mësimi i organizuar. Pjesa e hulumtimit / kërkimit është strukturuar si në vijim: dy vjet të studimit në pjesën kërkimore të përgatitjes së disertacionit janë vlerësuar me 120 PK. Këtu përfshihet edhe të paktën një punim (artikull) shkencor i botuar ose i pranuar për botim në revista të njohura ndërkombëtarisht për disiplina të veçanta shkencore. Alternativisht, kërkohet botimi ose pranimi për botim i së paku tri punimeve në revista cilësore në rajon.¹

Përgatitja e tezës së doktoratës: Në përgatitjen e disertacionit të doktoraturës përfshihen:

- prezantimi i projektit të disertacionit të doktoraturës,
- përgatitja e seminarit përfundimtar të doktoraturës,
- hartimi i disertacionit të doktoraturës dhe
- mbrojtja e tezës së doktoraturës.

Në forma të studimit mund të pranohen edhe:

¹Lista e revistave të pranueshme do të shpallet dhe përditësohet çdo vit nga Komisioni për Doktoratë i AAB-së

- përvojat, studimet nga angazhimet e bëra në universitete të tjera (në qoftë se ato janë të shprehura në ECTS kredi ose, sa herë që kjo të jetë e mundur, e konvertuar në pika të krediteve);
- angazhimin dhe punën me vlerë kërkimore të kryer në organizata e institucione ekonomike e shoqërore.
- Në përputhje me programin e hartuar të gjitha ato obligime vlerësohen si forma të organizuara të studimit të shprehura në kredite (deri në 15 kredite).

Neni 5

Pranimi i studentëve

Kushtet e përgjithshme për regjistrim në programet e doktoraturës janë të përcaktuara me ligj. Në programin e doktoraturës mund të pranohet kushdo që ka përfunduar:

1. Programin e ciklit të dytë të studimeve në fushë përkatëse,
2. Një program studimi për profesionet e rregulluara (sipas direktivave të BE-së), nëse vlerësohet me 300 ECTS,
3. Programet studimore që përfundojnë me një diplomë universitare (Komisioni përkatës i formuar nga bartësi i programit do të vlerësojë kërkesat plotësuese - ndryshimet eventuale në kredite ECTS),
4. Një program studimi që çon në një diplomë master (me 120 kredite ECTS) apo specializim pas përfundimit të programit të studimit të arsimit universitar (katërvjeçar) dhe ai në programin e doktoraturës mund të njihet për kërkesat akademike në masën deri 60 kredite,
5. Programet e studimit që çojnë drejt specializimit, me kusht që të ketë përfunduar program të arsimit të lartë dhe të cilëve mund t'u vendosen kërkesa shtesë në masën 30 deri në 60 kredi,
6. Arsimit në universitete të huaja, në përputhje me kushtet e përshkruara si studentët e RKS.

Çfarëdo kushtesh shtesë për njohjen e arsimit të mëparshëm dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me regjistrim të kufizuar, vendosen nga programet individuale të studimeve për doktoraturë, në përputhje me dispozitat ligjore e rregulloret në fuqi. Vendimet përkatëse gjithnjë mbështeten me një shpjegim të hollësishëm me shkrim nga organi përgjegjës.

Neni 6

Mekanizmat kryesorë, kushtet për bartësit e lëndëve dhe mentorët

1. Senati i AAB-së miraton politikat për studime të doktoratës, programet e reja dhe plotësimet/përditësimet e atyre ekzistuese me propozim të Rektoratit ose të këshillave mësimor/shkencor të fakulteteve përkatëse.

2. Studimet e doktoratës në nivel të AAB-së koordinohen dhe implementohen nga Shkolla për Studime të Doktoratës (ShSD). Shkolla për Studime të Doktoratës udhëhiqet nga përgjegjësi i Shkollës për Studime të Doktoratës. Përbërja, detyrat dhe funksionimi i shkollës dhe e koordinatorit të studimeve është e rregulluar me Rregulloren përkatëse të miratuar në Senatin e AAB-së.
3. Komisioni i Senatit për Studime të Doktoratës është njëkohësisht edhe Këshill Shkencor i ShSD. Komisioni për Studime të Doktoratës përbëhet prej shtatë anëtarëve: pro-rektori për çështje akademike, pro-rektori për kërkime shkencore, përgjegjësi i ShSD, dy profesorë të AAB-së (anëtarë të Senatit), një anëtar i jashtëm (nga institutet shkencore në Kosovë) dhe një profesor i huaj (nga një institucion i arsimit të lartë jashtë Kosovës).
4. Në nivel të fakulteteve bartësit e programeve të doktoratës nga fakultetet/programet studimore janë automatikisht anëtarë ex-officio të Komisionit të Senatit për punë shkencore, kur ky funksionon si këshill shkencor i ShSD.
5. Programet e studimeve të doktoratës në nivel të fakulteteve/programeve koordinohen nga Koordinator i Programit të Doktoraturës. Vendimet kryesore akademike për implementimin e programeve të doktoratës merren nga këshillat mësimorë shkencorë të fakulteteve në bashkëpunim të ngushtë me ShSD.
6. Studimet e doktoratës në AAB koordinohen ngushtë me Institutin dhe Qendrat e Kërkimeve Shkencore në AAB. Koordinator i Institutit është anëtar sipas detyrës zyrtare i Komisionit të Senatit, ndërsa përgjegjësit e qendrave studimore bashkërendojnë aktivitetet e veta me koordinatorët e studimeve të doktoratës në nivel të fakultetit / programit.
7. Bartësit e lëndëve mund të jenë persona të cilët mbajnë një titull të vlefshëm të mësimdhënies (asistent profesor, profesor i asociuar dhe profesor i rregullt) dhe mund të provojnë shkencërisht përkatësinë në fushën e duhur të mbuluar nga programi i doktoraturës me referenca të duhura (3 deri në 5).
8. Mentor / ose bashkë-mentor i disertacionit të doktoraturës është personi i cili mban titullin e profesorit të arsimit të lartë ose personi shkencor (bashkëpunëtor shkencor, bashkëpunëtor i lartë shkencor dhe këshilltar shkencor) dhe ka demonstruar një aktivitet kërkimor dhe bibliografinë e duhur shkencore në fushën e temës së disertacionit të doktoraturës.
9. Në përputhje me vendimin e Komisionit mund të propozohet bashkë-mentorimi në rastet e një disertacionit ndërdisiplinor të doktoraturës dhe kur kjo shënon përparësi për programin e studimit. Në rast të propozimit të bashkë-mentorimit, komisioni duhet të vlerësojë përshtatshmërinë për temën dhe të arsyetojë propozimin me arsye substanciale.
10. Studenti/ja e zgjedh (bashkë)mentorin para regjistrimit në programin e doktoratës.
11. Për mentor mund të zgjidhet edhe një person nga institucionet e tjera arsimore/shkencore që janë të përfshira në implementimin e programit të studimit ose janë të punësuar në një institucion vendor ose të huaj me të cilin AAB ka marrëveshje të bashkëpunimit

institucional. Në këto raste, AAB emëron një bashkë-mentor nga radhët e profesorëve të AAB-së.

12. Një mentor mund t'i mbikëqyrë deri në pesë studentë të doktoraturës, të cilët janë të regjistruar në një program doktore, pasi të kenë plotësuar të gjitha kërkesat dhe kushtet e nevojshme. Ky numër nënkupton një periudhë deri katër vjeçare nga koha e pranimit të kandidatëve në vitin e parë të studimeve. Për bashkë-mentor nuk ka kufizim në numrin e studentëve të mbikëqyrur të doktoratës.

Neni 7

Dijet dhe aftësitë e përgjithshme (gjenerike)

Programet e reja të doktoraturës, sipas rekomandimeve të EUA përfshijnë mundësinë e ofrimit dhe zhvillimit të shkathtësive të përgjithshme dhe të transferueshme që do t'u ofronin doktorantëve mundësi më të mira për punësim. Përmbajtjet e këtyre lëndëve janë të rregulluara në fushat e mëposhtme: 1) komunikimi, 2) planifikimi i kërkimit – hulumtimit 3) marrëdhëniet ndër-personale dhe puna ekipore, 4) Organizimi, administrimi dhe menaxhimi, 5) përshtatja e tregut dhe 6) grupi i shkathtësive të departamenteve të veçanta.

Një listë e lëndëve të ofruara nga programet individuale të doktoratës përditësohet çdo vit dhe publikohet në faqen e internetit të AAB.

Neni 8

Procesi i miratimit, freskimit dhe ri-akreditimit të programeve të doktoraturës

1. Propozimet për studime të doktoratës duhet të miratohen fillimisht nga këshilli mësimor e shkencor i fakultetit përkatës dhe të dërgohen në Senatin e AAB-së në formë të shtypur dhe elektronike. Pjesë integrale e programit janë edhe materialet informative për studentët e ardhshëm - broshura me informacione. Broshura përgatitet në gjuhën shqipe dhe angleze.
2. Senati vendos për të gjitha programet e reja dhe ndryshimet e mëdha në kurrikula, në përputhje me kriteret për akreditimin dhe vlerësimin e jashtëm të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit. Përditësimet dhe ndryshimet e vogla josubstanciale miratohen nga koordinatori i Shkollës Doktorale.
3. Për ndryshimet e vogla të bëra në programin e doktoratës, Koordinatorin e SHSD, nëpërmjet të Rektoratit, vetëm e informon AKA-në, ndërsa në raste të ndryshimeve më të mëdha nis procedura për ri-akreditim. Një gjë e këtillë vlerësohet nga Senati dhe merret vendimi përkatës.

Neni 9

Shpallja e konkursit për pranimin e studentëve

Në shpalljen për pranimin e studentëve në programin e studimeve për doktoratë përfshihen të dhënat në vijim:

- Emri i fakultetit
- Emri i programit të studimeve
- Kohëzgjatja e studimeve
- Kushtet e pranimi
- Mënyra e implementimit të studimeve
- Afatet dhe veprimet për regjistrim

Neni 10

Përcaktimi i kërkesave themelore dhe barasvlerësimi për regjistrim në studimet e doktoraturës

Shpallja për pranim të studentëve duhet të tregojë kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve në rastin e numrit të kufizuar të kandidatëve. Të huajt (kandidatët të cilët nuk janë shtetas të Kosovës), kanë të drejtë konkurrimi me kushte të njëjta sikurse kandidatët vendorë. Ekuivalenca (barasvlerësimi) i arsimimit të fituar jashtë vendit do të përcaktohet në procesin e njohjes së kualifikimeve të huaja për arsimim të vazhdueshëm në Republikën e Kosovës, në përputhje me Statutin e AAB-së dhe dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 11

Aplikimi dhe përzgjedhja e kandidatëve

Aplikacionet dorëzohen në adresën e Rektoratit të AAB-së. Përzgjedhja e kandidatëve kryhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në programin e studimit. Regjistrimi në programet e doktoraturës bazohet në afatin e caktuar në shpallje, por jo më vonë se 30 shtator të vitit përkatës, në mënyrë që departamentet të mund të vendosin për kandidatët e pranuar jo më vonë se më 30 tetor. Përzgjedhja e kandidatëve të jashtëm do të bëhet në kushte dhe afate të njëjta sikurse për kandidatët vendorë.

Neni 12

Kontrata e studimeve

Kontrata për studime të doktoraturës përfshin:

- Programin dhe fushën e studimit,
- detyrimet e të dyja palëve në kontratë,

- shumën e tarifave dhe afatet e pagesës për studimet.

Kushtet e kontratës duhet të parashohin edhe rrethanat e kryerjes së punës hulumtuese dhe ndarjes së shpenzimeve përkatëse. Mentori/mentorja përcaktohet para regjistrimit të kandidatëve për studime të doktoratës. Pos kësaj, këtu parashihen edhe studimet dhe procedura për përgatitjen e disertacionit të doktoratës.

Mënyra e zgjedhjes së lëndëve

Studimet organizohen ashtu që studenti të mund të fitojë në secilin vit së paku 60 kredi ECTS. Mentori/ja së bashku me studentin vendosin numrin dhe llojin e lëndëve dhe programin e hulumtimeve që do të vijojë studenti gjatë periudhës së studimeve. Një numër i lëndëve interdiciplinare vendosen në bashkëpunim dhe me miratimin e bartësit të programit/koordinatorin e ShSD. Lëndët e tjera të nivelit doctoral mund të merren nëse janë identifikuar nga kandidati me rastin e regjistrimit dhe nëse janë miratuar nga bartësi i programit / këshilli mësimor e shkencor i fakultetit përkatës.

Studimet dhe punimi i disertacionit të doktoratës

Neni 13

Temat për disertacion

Studenti paraqet temën e vet të studimeve në vitin e parë ose të dytë të studimeve të doktoraturës në pajtim me plan-programin. Tema i propozohet këshillit të fakultetit, ose në programet ndërdisiplinore, Senatit të AAB-së, në përputhje me rregullat e programit.

Aplikimi i studentit me temën / propozimi për disertacion është një dokument prej 3 deri në 5 faqe i gjatë (pa literaturë) i shkruar që përmban:

- Propozimin për titullin e temës dhe propozimin e disertacionit, me referencë në literaturën përkatëse,
- Të dhënat biografike—një formë e përshtatshme e biografisë,
- Një listë e punimeve shkencore dhe arritje të tjera
- Data e regjistrimit të parë në studimet e doktoraturës

Prezantimi i temës së doktoraturës mund të bëhet edhe në mënyrë publike. Propozimin e disertacionit për doktoraturë të propozuar nga KMSH i fakultetit e miraton Senati, përfshirë edhe emërimin e një mentori/mentoreje dhe në rastet e studimeve interdiciplinare bashkë-mentorin/en. Propozimi për miratim të temës, pos kërkesës së kandidatit me anekset përkatëse dhe raportit të komisionit mbi përshtatshmërinë e disertacionit të doktoraturës, përmban edhe titullin e temës, propozimin për mentor/e (dhe në rastet e caktuara bashkë-mentorin/en) dhe emrin e programit të doktoraturës.

Bashkë-mentorimi duhet të shpjegohet më në hollësi.

Vlefshmëria e temës së miratuar është katër vjet. Pas kësaj periudhe, studenti /ja mund të kërkojë ose zgjatje të periudhës për të njëjtën temë, ose kërkon ndërrimin e temës nëse e vjetra është tejkaluar. Në rast se studenti / ja tërhiqet nga tema përmes një deklaratë me shkrim, atëherë tema konsiderohet e anuluar.

Neni 14

Emërimi dhe puna e komisioneve për vlerësimin e temës

- Jo më vonë se 30 ditë pas paraqitjes së disertacionit të doktoraturës, KM i fakultetit emëron një komision prej tre anëtarësh, të cilët vlerësojnë nëse kandidati i plotëson kushtet për marrjen e një doktore dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e temës së propozuar. Komisioni emërohet nga ekspertë në fushën e disertacionit të doktoraturës me një titull të vlefshëm të mësimdhënies ose të punës kërkimore – shkencore dhe të cilët kanë doktoratë dhe punime shkencore në fushën e disertacionit. Mentori ka të drejtë të marrë pjesë për qëllim sqarimi dhe ndihmesë (por pa të drejtë vendimmarrjeje) në punën e të gjitha komisioneve që shqyrtojnë punimin përkatës të mentoruar nga ai / ajo.
- Pas miratimit të temës nga komisioni, KM i fakultetit emëron një komision tre anëtarësh për leximin e temës.
- Pas leximit pozitiv, KM do të emërojë një komision për mbrojtjen e temës. Edhe në rastet kur mentori /ja nuk është anëtar / e e komisioneve ka të drejtë dhe detyrë të marrë pjesë në punën e komisionit në të gjitha fazat e disertacionit të doktoraturës, pa të drejtë vote.
- Së paku një anëtar i doktoraturës duhet të jetë i jashtëm (ndoshta nga universitete të tjera ose institucione të tjera kërkimore). Nëse këshilli i fakultetit emëron vetëm anëtarë të saj në komision, atëherë një vendim i tillë duhet të arsyetohet veçanërisht.

Neni 15

Teza e doktoratës dhe mbrojtja

- Disertacioni i doktoratës përfaqëson një kontribut të pavarur dhe origjinal në fushën e shkencës, temën e disertacionit. Disertacioni i doktoraturës është i shkruar në gjuhën shqipe dhe me një përmbledhje të gjerë në gjuhën angleze.
- Disertacioni i doktoraturës mund të jetë i përgatitur në bazë të punimeve të aplikuesit në fushën e disertacionit, të pranuar për botim, apo që tashmë janë botuar në revista të njohura ndërkombëtarisht, në përputhje me rregullat e miratuara në fakultetin që udhëheq procedurën.
- Kandidati/ja duhet të propozojë një punim disertacioni për mbrojtje brenda një afati prej katër vitesh nga data e miratimit të disertacionit të doktoraturës nga njësia që ka

udhëhequr procesin. Komisioni i përshtatshmërisë, jo më vonë se tre muaj nga dorëzimi i disertacionit të doktoraturës, duhet të hartojë një raport me shkrim. Bazuar në raportet e dorëzuara pozitive, këshilli i fakultetit përkatës cakton datën e mbrojtjes së tezës së doktoratës.

- Studenti, para mbrojtjes së temës, duhet të ketë botuar ose pranuar për botim shkencor të një punimi origjinal me autorësi të parë, në mënyrën dhe formën përkatës për disiplinat individuale shkencore.
- Në rast se autorësia e parë nuk është e mundur (për shembull, në kërkimin ndërkombëtar bashkëpunues, ose për shkaqe të tjera të arsyeshme), mentori / ja me një deklaratë të veçantë siguron që botimi origjinal shkencor nuk ka qenë përdorur si një kontribut për studimet e doktoraturës së një kandidati tjetër të doktoratës.
- Mbrojtja është publike. Shpallja e mbrojtjes do të publikohet së paku tetë ditë para mbrojtjes. Mbrojtja do të regjistrohet dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët. Mbrojtja e suksesshme e studentit/ës për doktoraturë akademike fiton titullin doktor / e i shkencave për fushën përkatëse.

Neni 16

Hartimi i doktoratës në një gjuhë të huaj

- Mund të miratohet hartimi i disertacionit në gjuhën angleze nëse kandidati është i huaj dhe nëse mentori dhe ose bashkë-mentori janë të huaj. Për rastet e studimeve në gjuhë të huaja Senati mund të miratojë hartimin e punimit në gjuhën e huaj përkatëse.
- Në rastin e një tezë në anglisht ose në një gjuhë tjetër të huaj, atëherë hyrja, konkluzioni dhe një përmbledhje e plotë do të bëhet në gjuhën shqipe. Të gjitha dokumentet e nevojshme të dorëzuara për disertacionin e doktoraturës duhet të shkruhen në gjuhën shqipe.
- Në përputhje me vendimin e Senatit të AAB-së titulli i temës duhet të përkthehet edhe në gjuhën shqipe.
- Mbrojtja është publike dhe organizohet nga Rektori në lokalet e Universitetit .

Promovimi

Neni 17

Përgatitja e materialeve për promovim

- Fakulteti i cili ka kryer procedurën, menjëherë dërgon të dhënat e mbrojtjes dhe çdo shërbim tjetër të dokumentacionit për studimet e doktoraturës në AAB – Lajmërimi i promovimit të doktorit të shkencave. Formulari përmban informacion në lidhje me kandidatin/en, punimin e doktoraturës, mentorin / en dhe botimin e një artikulli shkencor apo një serie të artikujve.

- Departamenti i Studimeve të Doktoraturës mban një regjistër të doktorëve të promovuar me të gjithë informacionin përkatës.
- Nxjerrja e diplomës: AAB nxjerr diplomën e cila përmban të dhënat kryesore: emrin, titullin, datën, emrin e mentorit dhe të bashkë-mentorit.
- Përveç diplomës së doktoratës lëshuar nga Universiteti, të gjitha fakultetet duhet të lëshojnë shtojcën e diplomës në gjuhën shqipe dhe angleze. Forma e shtojcës së diplomës është në formën e përshkruar nga Ministria e Arsimit (MASHT).

Neni 18

Promovimi formal i doktoraturave të reja / doktorëve të shkencave

- Bazuar në të dhënat e ofruara nga departamenti përkatës – sekretaria, Rektori bën një promovim solemn të doktorëve të rinj.
- Promovimi solemn i doktorëve të rinj dhe dhënia e diplomave universitare bëhet në sallën solemne të AAB. Në ceremoninë e promovimit të doktoratës do të marrin pjesë dekanët përkatës, senatorët, mentorë dhe mysafirë të ftuar.
- AAB do të mbajë një regjistër të veçantë për doktorët e promovuar dhe doktoraturat e mbrojtura.

Prof.dr. Lulzim Tafa, Rektori
